

I. Kuadri Kontabel i Aplikuar.

Gjatë periudhave ushtrimore deri me 31.12. 2007, Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore në Shqipëri të përcaktuara në Ligjin 7661 datë 19 Janar 1991 “Për Kontabilitetin” dhe Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore të aprovuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr.334 datë 9 Korrik 1993. Në datë 29.04.2004 u miratua Ligji Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe më pas u miratuan edhe Standartet Kontabël që lidhen me të. Ky ligj i ri përcaktoi zbatimin në Shqipëri të Standarteve Kombetare Kontabël (të njohura si SKK) për të gjitha shoqëritë tregëtare. Zbatimi i parë i tyre parashikohet në periudhën ushtrimore që përfundonte më 31 Dhjetor 2008. Standartet Kombëtare Kontabël të miratuara, që do të zbatohen nga shoqëritë e Vogla dhe të Mesme të cilat përqëndrohen në zërat më kryesore të Pasqyrave Financiare të shoqërive.

Pasqyrat financiare të periudhës 01.Janar.2019 - 31.Dhjetor.2019, në përberje të cilave janë (Aktivet, Pasivet dhe Kapitali, Pasqyrat e të Ardhurave dhe Shpenzimeve sipas Natyrës dhe Funksioneve, Pasqyrat e Fluksit Monetar me metodën Direkte dhe Indirekte, Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital e Konsoliduar dhe e pa konsoliduar) për periudhën e më sipërme janë përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit nr.9228 datë 29.04.2004”Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, nënart 4 deri 18 të këtij ligji dhe Standartet Kombetare të Kontabilitetit të vendit tone.

Bilanci në përberje të pasqyrave financiare tregon pozicionin financiar (aktivet, pasivet dhe kapitalin) të Shoqërisë “Dinamika” shpk me datë 31.12.2019.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet dhe humbjen) e Shoqërisë “Dinamika” shpk për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave (Arketimet dhe pagesat në para dhe ekuivalentet e saj) të Shoqërisë “Dinamika” shpk për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital tregon ndryshimet në kapitalin e Shoqërisë “Dinamika” shpk për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019.

I. Informacione të Pergjithshme

1.1 Të dhëna për Shoqërinë

Shoqëria “Dinamika” sh.p.k. është rregjistruara me Vendimin nr 9063 datë 21.02.1995 të Gjykatës së Shkalles së Parë Tirane si: Ndertim – Prodhim etj.

Selia: Rruga Nacionale Sarandë – Gjirokaster km 7, Zona Industriale, Vriion- Delvine.

Objekti i veprimtarisë është ndertim, prodhim betoni, materialeve inerte si dhe tregëtimi i tyre, shërbimet e ndertimit etj.

Shoqeria “DINAMIKA” SHPK VRION -DELVINE

Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

1.2. Baza e Përgatitjes

Ligji i ri i Kontabilitetit promovon zbatimin ligjore të standarteve nga shoqëritë.

Shoqeria ka vënë në zbatim aplikimin të Ligjit për Kontabilitetin për përgatitjen e Pasqyrave Financiare për periudhën ushtrimore që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) dhe interpretimet e standarteve të shpallura nga Ministria e Financave.

Shoqeria si një përdorues për HERE TE PARE më 31 Dhjetor 2008 ndoqi rregullat e përcaktuara në SKK 1 për zbatimin për herë të parë të SKK-ve nga Shoqëritë.

Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri. (SKK2; 49)

Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare: Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara. (SKK 1,35)

Parimet dhe karakteristikat çesore të përdorura për hartimin e pasqyrave Financiare (SKK 1, 37-69)

- a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike të veta.
- b) VIJMESIA e veprimtarisë ekonomike të njësive sone raportuese është e siguar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.
- c) KOMPESIMI midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK
- d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
- e) MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zërat material
- f) BESUSHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguar pasi nuk ka gabime material duke zbatuar parimet e mëposhtme :

- Parimin e paraqitjes me besnikëri
- Parimin e përparësive së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
- Parimin e paanëshmerisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
- Parimin e maturisë pa optimizim të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
- Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të PF.
- Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabel.
- Parimin e krahasueshmërisë duke siguar krahasimin midis dy periudhëve.

Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore janë përfshirë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2019.

II . Politikat kryesore kontabele.

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE

Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te aplikuar ne Pasqyrat financiare jane si me poshte:

2.1. Mjetet Monetare.

Per Mjetet monetare ne arke dhe ne banke eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit ”Vlera e drejte” , sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.3.

Mjetet monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise qe daton 31.12.2019.

2.2. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.

Per Aktivet e tjera financiare Afatshkurtera te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit “Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem” ,sipas paragrafit nr.26, 27 te SKK-se nr.3. Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

2.3. Inventari

Per Inventarin e paraqitur ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit “Kosto historike”, sipas paragrafit nr.14, 15 te SKK-se nr.4. Kostoja eshte llogaritur duke perdorur Metoden e mesatares se ponderuar.

2.4. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra.

Per Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit “Kosto historike “ ,sipas SKK-se nr.8.

2.5. Aktivet Afatgjate Materiale.

Per Aktivet Afatgjate Materiale te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit “Kosto historike minus amortizimin e akumuluar ne vite” , sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.5

2.6.Huamarrjet afatshkurtera.

Per Huamarrjet Afatshkurtera te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit “Kosto e amortizuar”, sipas paragrafit nr. 32, 33 te SKK-se nr. 3. Vlera nominale e huamarrjeve afatshkurtera eshte amortizuar me kestet e likujdimit ne periudhe.

2.7.Huat dhe parapagimet.

Shoqeria “DINAMIKA” SHPK VRION -DELVINE

Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Per Huat dhe parapagimet te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit “Kosto e amortizuar”, sipas paragrafit nr. 32, 33 te SKK-se nr.3. Vlera nominale e huamarrjeve eshte amortizuar me kestet e likuidimit ne periudhe.

2.8.Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel. Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat i ndonje SKK-je.

2.9.Te Ardhurat dhe Shpenzimet.

Vleresimi i te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes.Vleresimi I tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35 - 37 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

Te ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyres.

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të shoqërisë, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). Pjesa më e madhe të shitjeve të shoqërisë gjenerohen nga shërbimet e ndërtimit, prodhim betone e inerte dhe nga shitja e tyre.

Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet.

Shpenzimet përfshijnë shpenzimet për materialet e konsumuara, si dhe nga shpenzimet e tjera rrjedhese me vleren ne momentin e ndodhjes (parimi i konstatimit te drejtave e detyrimeve).

2.10.Tatimi aktual

Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ose te kompensohen nga dega e tatimeve.

2.11 Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

2.12 Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

humbjet, regjistrohesh në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2019 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2019
Euro	123.03	122
\$	122	118

III. Informacion-Shtese per zerat Materiale.

3. Mjetet Monetare.

Gjendja e “Mjetet Monetare” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Pasqyra e Likuiditeteve 308345 LEKE

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten 31.12.2019, per shumen 37.435 leke me teprice debitore e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe, si dhe gjendjen e arkesh ne daten 31.12.2019 per shumen 270.910 lek. Gjendjet sipas bankave dhe arkesh paraqitet ne aneksin shtese **I.A.A.1.**

4. Aktivet e tjera financiare afatshkurtra.

Gjendja e “Aktiveve te tjera Financiare Afatshkurtra” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Pasqyra e Kerkesave te arketueshme

Aktivete e Tjera Financiare Afatshkurtra krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar rritje, ne strukture dhe ne total. Kerkesat e arketueshme kane rritje ne vleren 11854335 leke. Aneksi shtese **I.A.A.3.**

5. Inventaret.

Gjendja e “Inventareve” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Pasqyra e Inventareve 973280 leke

Shoqeria “DINAMIKA” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

“Inventaret” krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar nje ulje ne vleren 390899 lek, Inventari i “Stokut” per disa artikuj te furnizuar gjate muajit Dhjetor paraqitet ne aneksin shtese **I.A.A.4.**

6.Aktivet Afatgjata Materiale.

Ne total “Aktivet Afatgjata Materiale”, per vitin 2019 kane ndryshim ne shtes per vleren 65000 leke, per blerje kompjuter per vleren 25000 leke dhe ne ndertim per vleren 40000 leke , ne pakesim amortizime kemi perlllogaritur per vleren 5100000 leke per ndertesa 3 % per mjete trasporti, makineri paisje 10 % paraqitet e ndryshuar si me poshte:

Inventari kontabel i “Aktivet Afatgjata Materiale” paraqitet ne aneksin shtese **II.A.A.2.**

7.Detyrimet afatshkurtera.

Gjendja e “Detyrimeve afatshkurtera” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Detyrimet Afatshkurtra	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2019</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Derivativet (vlere negative)	-	-	-
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	-	-	-
Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	--	-	-
Kredi bankare	1177275	0	-1177275
Te pagueshme ndaj furnitoreve	43451536	44220025	+768489
Te pagueshme ndaj punonjesve	-	-	-
Debitore, kreditore te tjere	-	-	-
Totali	44628811	44220025	+408786

Ne strukture te grupit rezulton se ka nje rritje detyrimesh te furnitoret per vleren 768489 leke, “Huamarrjeve afatshkurter” (Kredia eshte likujduar gjate vitit 2019 tek Banka Societe Generale) , paraqitet ne aneksin shtese **I.D.A..**

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

8.Detyrimet Tatimore.

Gjendja e “Detyrimeve Tatimore” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>Dhjetor 2019</u>	<u>Ndryshimi</u>
Tatim mbi fitimi	-90041	-499270	-409229
TVSH per tu paguar	-538598	-423841	114757
Akcize	-	-	-
Sigurime shoqore e Shendetsore	-84816	-84258	-558
mbi te ardhurat persc	5200	-3900	-1300
Tatime e taksa te tjera	-	-	-
	52489	-	52489
	<u>-771144</u>	<u>1011269</u>	<u>-240125</u>

Detyrimet tatimore kane nje rritje nga viti kaluar. Ne strukture te detyrimve tatimore “Shteti Tatim fitimi” paraqitet me mbetje pasive ne total per 499270 leke. TVSH paraqitet me nje mbetje pasive ne total per 423841 leke. Sigurimet shoqerore paraqiten me mbetje pasivene total per 84258 leke. Tatim page per 3900 leke. Tatim ne burim per shperndarje fitimi (Divident) eshte mbyll gjate vitit .Te cilat likujdohen ne datat 14 dhe 20, te muajit Janar te vitit 2019. Te analizuara sipas pozicionit ne bilanc detyrimet tatimore jane ne anekset shtese.

9. Huat afat gjate me 31.12.2019

Huaja afat gjate, kredia u shlye gjate periudhes ushtrimore, nuk rezulton te kete me 31.12.2019.

10.Kapitali

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Paraqitet sipas sipas pasqyres se ndryshimeve ne kapitalin neto qe ndodhet ne pasqyrat financiare

Kapitali ne strukturen e tij ka ndryshime lidhur me shperndarjen e fitimit qe rezultonte ne bilancet e viteve, rezerva ligjore eshte 1116416 leke, dhe kapitali aksioner eshte shuma ne vleren 114072721 leke me 31.12.2018. Fitimi i rezultuar ne bilancin e vitit 2018 per vleren 2906314 leke u eshte shperndare ortakeve shuma per vleren 2691031 leke dhe shuma per vleren 215283 leke dividend me masen 8% i eshte kaluar tatimeve sipas muajve te pages. Ndersa me 31 Dhjetor 2019 kapitali aksione eshte per vleren 119559591 leke se bashku me fitimin e vitit 2019 qe rezulton ne vleren 8393592 leke.

11.Fitim/Humbja e Vitit Financiar.

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Fitimet e Vitit Financiar 2019 eshte rezultante e te ardhurave ushtrimore dhe Shpenzimeve ushtrimore. Ne pasqyren e meposhtme do te paraqitet formula e fitimit te Vitit Financiar ne dy periudhat e fundit ne krahasim :

12.Të ardhurat

Për periudhën kontabël që mbyllet më 31 Dhjetor 2019 Shoqeria ka realizuar të ardhura të cilat rrjedhin nga shitja e betoneve, cimentos, pune publike, inerte, apatamente etj.

Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31- dhjetor-18	31- dhjetor-19
Shitje betoni	27203013	60597376
Shitje cimento	232800	0
Pune publike	2194060	0
Shitje inerte	586765	0
Te tjera	79701	435032
Te ardhura nga kembimet valutore	-	-
Totali	30296339	61032408

Te ardhurat e ushtrimit ne total jane ne vlere 61032408 lek, te cilat kane ardhur :

1. Nga shitja e betonit prej 60597376 leke
2. Te tjera prej 435032 leke.

Kemi nje rritje te shifres se afariazimit duke e krahasuar me vitin e kaluar ose ne vlere leku per 30736069 leke me shume .

13.Blerje Mallarsh

Shpenzimet per blerejn e mallrave perfshijne shpenzimet per mallrat dhe materiale qe perdoren gjate procesit te prodhimit dhe shitjes se betonit, shitjes te cimentos, punime me makineri, mirembajtjen e mjeteve, makinerive, linjes se betonit, per blerje dhe transport me mjetet tona (Rere, cakell, granil, gure etj) inerte nga Subjekti Arti shpk etj.

Shumat ne Leke

Pershkrimi I Llogarive	2018	2019
Blerje Karburant vajra	5195608	10464144
Cimento	10401200	19602223
Energji Elektrike	240328	284168
Blerje inerte	3469937	7040916
Pjese nderrimi e tjera	1273591	389940

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Blerje goma + bateri	670520	422104
Blerje material te ndryshme	91080	42052
Totali :	21342264	38246547

14. Shpenzimet e Personelit

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe të tjera shpenzime të personelit.

Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	2018	2019
Pagat	3423290	3636130
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore	571671	607234
Shpenzime për pensionet	-	-
Trajtime përfundimi Raporti Pune	-	-
Të tjera Shpenzime të personelit	-	-
Provigjone për personelin	-	-
Totali	3994961	4243364

15. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Në shpenzimet e tjera të shfrytëzimit janë përfshirë shërbimet e kryera nga të tretët janë përfshirë shpenzimet e punimeve dhe shërbimeve të kryera nga të tretët për punime, shpenzimet për kontrollin e kolaudimit e mjeteve, siguracione mjeteve e puntoreve, konsulencë juridike, auditim bilanci, kancelarie, shpenzime komunikimi, tarifa shërbimi , reklama, shërbime bankare etj, sipas tabelës së mëposhtme:

Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	31- dhjetor- 18	31- dhjetor-19
Taksa lokale, televizori etj	2300	442848
Shpenzime Automjetesh e sigurac.	430151	1759347
Shpenzime Ligjore, Kontabël, Juridike, ekspertiza , etj	141560	212328
Shpenzime kancelarie dhe të ngjashme	33967	134121
Shpenzime Komunikimi dhe të ngjashme	20000	20002
Shpenzime të tjera financiare	77548	79978
Shërbime Bankare	121492	589625
		119675

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Totali	827018	3357924
---------------	---------------	----------------

16.Rënia e vlerës dhe zhvlerësimi i Aktiveve Afatgjata

Në këtë post të shpenzimeve paraqitet vlera neto nga amortizimi i aktiveve afatgjata materiale.

Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	31- dhjetor-18	31-dhjetor- 19
Zhvlerësimi dhe amortizimi	0	5100000
Rënie ne vlerë	0	0
Totali	0	5100000

Duke qene se rezultati financiar rezulton me fitim kemi bere perlogaritje amortizimi per (Aktivet afatgjate materiale) si mjete trasporti 10%, makineri paisje vegla 5-10%, ndertimet 3 %, zyre levizese 3% te tjerat 20% mbi vleften e mbetur, sipas pasqyrave te A.A.Materiale me vlefte fillestare, amortizimi dhe me vleften e mbetur.

17.Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare te pa zbriteshme jane per vleren 1191344 leke te cilat jane: (Gjobat dhe kamat vonesat per vleren 108252 leke, shpenzime te viteve te kaluara (taksa mjetesh dhe taksa per bashkin) per vleren 1083092 leke te likujduara nga ana e jone gjate vitit 2019) dhe jane kaluar ne shpenzime.

Ne total subjekti rezulton me nje fitim neto te vitit financiar per vleren 8393185 leke.

Ekonomisti
Thanas Qirjaqi

Administratori
Janaq Papajani

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

	-	
	-	-

Shoqeria “ DINAMIKA ” SHPK VRION -DELVINE
Shenime: Pasqyrat Financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2019